



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Punë/Pratete Received/Delivered	04.04.2023	3	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3295/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.316/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.316/2023 të datës 06.02.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.316/2023 e datës 06.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet ne fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për periudhën kohore nga datat 16.06.2022 deri më 02.11.2022 i datës 31.01.2023.

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë, më datë 06.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me numër:1410/2023 nën shenjën A.nr.316/2023, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës të datës 31.01.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill me pretendon se së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe

Nëpunësve të Shërbimit Publik, pasi që i njëjti meriton notë me të lartë të vlerësimit lidhur me arritjen e objektivave, me kërkesën që Këshilli të ndryshojë notën e vlerësimit të ankuesit apo ta kthejë lëndën në rishqyrtim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 22.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datë 22.03.2023 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 06.02.2023 me Nr.Prot:1410/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 31.01.2023; E-mailin e datës 31.01.2023 dërguar nga Rims MPB për ankuesin; E-mailin e datës 30.06.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 30.06.2022 dërguar nga ankuesi për L.N i orës 12:09; E-mailin e datës 01.07.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; Vendimin e këshillit A.nr.358/2022 i datës 26.05.2022; E-mailin e datës 30.08.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 30.09.2022 dërguar nga ankuesi për L.N me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 04.11.2022 dërguar nga ankuesi për L.N me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 15.08.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 14.11.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; Vendimin e datës 04.10.2022 me numër ref:1617/2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; E-mailin e datës 13.10.2022 dërguar nga ankuesi për L.N me korrespondencën e bashkangjitur prej katër (4) faqesh; E-mailin e datës 05.10.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 14.07.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; Memorandumin e Bashkëpunimit; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga ankuesi për A.K; -mailin e datës 08.11.2022 dërguar nga ankuesi për F.Z me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 30.06.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 05.08.2022 dërguar nga ankuesi për V.G; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga ankuesi për B.P dhe L.N etj.; E-mailin e datës 15.08.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 15.08.2022 dërguar nga ankuesi për A.D; E-mailin e datës 17.08.2022 dërguar nga ankuesi për V.G; E-mailin e datës 18.10.2022 dërguar nga ankuesi për Sh.N; E-mailin e datës 19.10.2022 dërguar nga ankuesi për S.K; E-mailin e datës 29.08.2022 dërguar nga ankuesi për A.D me korrespondencën e bashkangjitur; Vendimin e datës 30.08.2022 me numër:1378/2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së; E-mailin e datës 29.08.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 31.08.2022 dërguar nga ankuesi për B.M, Sh.T etj; E-mailin e datës 13.09.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 14.09.2022 dërguar nga ankuesi për F.Th; E-mailin e datës 26.09.2022 dërguar nga ankuesi për L.N; E-mailin e datës 06.10.2022 dërguar nga ankuesi për H.I; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga H.H për ankuesin; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i ankuesit për periudhën 01.01.2022 deri 16.06.2022 i datës 31.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.02.2023; E-mailin e datës 20.03.2023 dërguar nga V.D për këshillin me korrespondencën e bashkangjitur; Shkresën e datës 20.03.2023; Ndryshimi i Aktit të Emërimit i datës 14.12.2018; E-mailin e datës 17.03.2023 dërguar nga L.N për V.D; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve; Vendimin e Këshillit A.nr.644/2021 i datës 03.03.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i ankuesit për periudhën nga 16.06.2022 deri 02.11.2022 i datës 31.03.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *pabazuar*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Plotësimit dhe Ndryshimit të Aktit të Emërimit të datës 14.12.2018 mbanë pozitën "Udhëheqës i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve" në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa udhëheqësi i ti i drejtpërdrejtë përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 31.01.2023 ankuesin e ka vlerësuar me notën e përgjithshme mesatare dy pikë pesëdhjetë e dy (2.52) për periudhën kohore nga data 16.06.2022 deri me datë 02.11.2022.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sa i përket notës së përgjithshme të vlerësimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: "Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë", ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: "Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës", prandaj marrë për bazë Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesin i datës 31.01.2023 përmes të cilat ankuesi ishte rivlerësuar me notë të përgjithshme mesatare (2.52) për periudhën kohore nga data 16.06.2022 deri me datë 02.11.2022, Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ankuesi është vlerësuar "mirë" në kuptim të dispozitave të lartcekura të rregullores, nga rrjedh si i njëjti vlerësohet se i ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi është vlerësuar për objektivat si vijon: 1. Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migrimit, 2. Zbatimi i Rregullores për Funkcionalizimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve si dhe 3. Realizimin e detyrave në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës, nga rrjedh se objektivat e tilla të punës të përcjella me aktivitetet e specifikuara si në formularin e vlerësimit, në bazë të përshkrimit të detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve" i përshtaten fushëveprimet të detyrave funksionale të pozitës së ankuesit.

Prandaj, nga analizimi i shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse edhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme mesatare "2.52, mirë" e që në kuptim të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik vlerësohet se i njëjti i ka arritur të gjitha objektivat punës dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, prandaj mbi këtë bazë udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 7 të së njëjtës rregullore, ngase ankuesi është vlerësuar edhe për arritjen e objektivave sikurse edhe për sjelljet profesionale, ndërsa ankuesi nuk ka mundur të mbështes pretendimet e tij ankimore se i njëjti është dashur të vlerësohet me notë më të lartë e që në kuptim rregullores së lartcekur pas notës së vlerësimit të ankuesit është

nota "shumë mirë" me të cilën mund të vlerësohet nëpunësi civil i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit i paraqitur në ankesën e datës 06.02.2023 të parashtruar në Këshill është i pabazuar, ngase argumentet e tij nuk janë bindësi se i njëjti ka ndikuar në performancën e përgjithshme të institucionit.


Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.316/2023

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit


Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

